



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

Hyrje

Si pjesë e mandatit për ndërtimin e institucioneve, Misioni i OSBE- së në Kosovë është duke ndihmuar zhvillimin e sistemit juridik të bazuar në parimet demokratike dhe standardet e të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës.

Sistemi juridik në Kosovë ka qenë në gjendje shumë të keqe kur ka filluar punën OSBE në vitin 1999. Me themelimin e sistemit gjyqësor të rregulluar dhe udhëhequr nga UNMIK-u dhe i cili ishte quajtur Sistemi emergjent juridik- Seksioni për trajnim gjyqësor pranë misionit të OSBE- së ka iniciuar këto aktivitete.

Si pasardhës i këtij seksioni, në shkurt të vitit 2000 është krijuar Instituti gjyqësor i Kosovës. Mandati i tij është të trajnojë gjyqtarët dhe prokurorët, dhe të kontribuoj në zhvillimin e gjyqësisë dhe prokurorisë profesionale, të paanshme, dhe në shërbim të popullit të Kosovës, si dhe të fitoj besimin në institucionet vendore.

Gjatë disa viteve të fundit, IGJK-ja vazhdimisht ka përshtatur aktivitetet e saj trajnuese për ndërrimin e ambientit ligjor si dhe u është përshtatur nevojave trajnuese të anëtarët të gjyqësisë. Fillimisht, IGJK-ja ka ofruar trajnime të përgjithshme mbi standardet për të drejtat e njeriut dhe për ligjin penal. Më vonë është përqendruar në disa materie të veçanta ligjore që ishin prioritare, siç ishte ligji penal, ligji mbi procedurën penale, dhe me referenca në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Një gjë e tillë ishte bërë për të rifreskuar njohuritë për gjyqësinë që kanë të bëjnë këto lëmi të veçanta.

Shtirja e aktiviteteve trajnuese të IGJK-së është ende në zgjerim e sipër. Duke rritur kompetencat profesionale dhe teknike të gjyqtarëve të Kosovës, IGJK-ja përkrahë implementimin e standardeve për Kosovën, në veçanti standardet për qasje të barabartë në gjyqësi dhe të drejtat pronësore.

Për momentin, IGJK-ja është ende pjesë e Misionit të OSBE-së. Mirëpo, do të nxirret një projekt ligj i cili do ta pavarsojë IGJK-në si një institucion të pavarur në strukturën e përgjithshme qeveritare, dhe kjo është paraqitur në Kuvendin e Kosovës. Miratimi i këtij projekt ligji pritet të bëhet nga mesi i vitit 2005. Kështu, IGJK-ja do të funksionoj si një institucion i qëndrueshëm vendor i cili do të ofroj trajnime fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm, trajnimet themelore për gjyqtarët ndihmës, si dhe trajnime përmirësuese në vazhdimësi për gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës.



Projektligji për IGJK-në parasheh që IGJK-ja të jetë përgjegjëse për organizimin e programit fillestar për arsimim ligjor i cili do t'i përgadis gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm për rolin e tyre në gjyqësor.

PËR INFORMATA KONTAKTOM:
Zyrën për informim publik
Sëka e misionit të OSBE-së,
38000 Prishtinë

TEL: +381 38 500 162
Fax: +381 38 500 188,
www.osce.org/kosovo
press.omik@osce.org



Misioni i OSBE-së në Kosovë FLETË FAKTESH

PËRMBLEDHJA E AKTIVITETEVE

Vazhdimi i programit edukativ ligjor për gjyqtarë dhe prokurorë

Vazhdimi i programit edukativ ligjor për gjyqtarë dhe prokurorë përfshinë aktivitete edukative si në Kosovë dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit 2004, IGJK-ja ka dedikuar një numër të madh të seancave trajnuese aspekteve substantive dhe procedurale të sistemit të reformuar të ligjit penal, duke ofruar 12 seanca të specializuara trajnuese të temave siç janë paraqitura e veprave të reja penale, llojet e reja të dënimeve, trafikimi me qenie njerëzore, si dhe rolin e ri të prokurorëve publik, policisë gjyqësore dhe gjyqtarëve të procedurës paraprake.

Janë ofruar një numër i konsiderueshëm i programeve trajnuese profesionale për të siguruar gjyqësinë me aftësi praktike që kanë të bëjnë me sistemin e ri penal.

IGJK-ja gjithashtu i ka zgjeruar aktivitetet e saj në ofrimin e trajnimeve nëpër regjione. Kjo për faktin se janë bërë dispozita të konsiderueshme në kodin penal dhe në kodin e procedurës penale, diskutimeve në tryezë të rrumbullakët që do të mbahen në tërë Kosovën. Ato përqendrohen në brengat substantive penale ose procedurale që gjyqtarët dhe prokurorët do të ballafaqohen nëpër gjykata në regjionet e tyre. Pasiqë ligji civil ka të bëjë me kompetencat për kundërvajtjet që janë prej një rëndësie të madhe, IGJK-ja në trajnimet e saj ka vazhduar t'i mbulojë edhe këto tema.

Në vitin 2004, IGJK-ja ka mbajtur 52 seanca trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë. Disa prej programeve trajnuese janë organizuar posaçërisht nga IGJK-ja të tjerat janë mbajtur në bashkëpunim me institucionet tjera që ishin partnerë, siç janë Këshilli i Evropës, Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve, Oda e avokatëve të Amerikës- ABACEEI, si dhe Qendra kombëtare për gjykatat shtetërore.

Që nga fillimi i vitit 2005, IGJK-ja vazhdon të përmirësojë kualitetin e trajnimeve. Për t'u bërë edhe më sistematik për qasje në edukim, në fund të vitit 2004, IGJK-ja ka paralajmëruar fillimin e programit trajnues në vazhdimësi për vitin 2005. Programi i këtij viti përqendrohet në ndryshimet më të reja të legjislacionit si në ligjin civil, ashtu edhe në atë penal, duke përfshirë këtu edhe zbatimin e kodit të përkohshëm penal, kodin e procedurës së përkohshme penale si dhe kodin për të miturit, përderisa mëton më tutje të zhvillojë aftësitë praktike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. IGJK-ja është duke organizuar një numër të konsiderueshëm të seminareve nëpër regjione, duke zbatuar metoda moderne të të mësuarit. Në fillim të këtij viti, IGJK-ja ka mbajtur simulimin e parë të një seance gjyqësore, dhe tani është duke u përqendruar më shumë në studimin e rasteve nëpër seanca trajnuese.

Arsimimi jashtë vendit

Komponentë tjetër e edukimit në vazhdimësi është edhe programi për edukim jashtë vendit, i cili përbëhet prej vizitave studimore dhe internshiptit. Këto vizita kanë për qëllim që të promovojnë diskutimet për problemet e sistemeve të ndryshme gjyqësore si dhe të ndajnë përvojat me kolegë në mënyrë që të përmirësojnë praktikën gjyqësore në Kosovë. Zakonisht, pjesëmarrësit i vizitojnë Ministrinë e Drejtësisë si dhe institucionin kryesor të gjyqësisë të shtetit ku shkojnë për vizitë, si dhe vëzhgojnë procedurat në shkallën e parë dhe të dytë të gjykatës. Në vitin 2001 ishin bërë vizita në Poloni, Zvicër dhe në Holandë (Hagë). Në vitin 2002 IGJK-ja ka organizuar vizita në Francë (Paris dhe Strasbourg), Kroaci, Zvicër dhe në Holandë (Hagë). Në vitin 2003, vizitat e gjyqtarëve në Slloveni, Zvicër dhe Gjermani. Dhe në vitin 2004 janë bërë disa vizita në Gjermani, Bullgari dhe Francë.

Segmenti i internshiptit të programeve të edukimit jashtë vendit u ka mundësuar pjesëmarrësve që të vëzhgojnë punën e një gjyqtari dhe prokurori në sistemin juridik të tyre. Këto internshipe janë si shtesë e zhvillimit të aftësive të tyre profesionale, në veçanti në arsyeshmërinë ligjore, teknikave të marrjes në pyetje, etiketimin dhe udhëqjen e gjykatave. Në parapërgatitjet për internship, pjesëmarrësit kishin përcjellur një kurs intensiv tregues për institucionet gjyqësore të shteteve që do t'i vizitonin. Pas kthimit, ishin organizuar punëtori për të ndarë përvojat e fituara me vizitat e tyre.

Në vitin 2005, programi ka vazhduar me trajnimin e trajnuesve për gjyqtarët vendor dhe prokurorët vendor të cilët gjithashtu ofrojnë ligjërata në institut. Gjithashtu, personeli vendor i IGJK-së do të vizitoj Institutin kombëtar të drejtësisë në Bullgari për të këmbyer përvoja.

Programet trajnuese për aftësi praktike

Programet trajnuese për aftësi praktike kanë filluar në tetor të vitit 2002 dhe përfunduan në shtator të vitit 2003. këto programe janë mbajtur në bashkëpunim me Agjensionin amerikan për zhvillim ndërkombëtar (USAID), të cilët kanë kontraktuar Organizatën ndërkombëtare për zhvillim të ligjit për të ofruar trajnime për gjyqtarët kosovarë. Ky kurs i cili është mbajtur në IGJK u ka ofruar gjyqtarëve dhe prokurorëve aftësi praktike që ndërliken me aspekte të ndryshme të procedurave të gjykatës dhe të seancave gjyqësore, siç janë vendimarrja, shqiptimi i vendimeve gjyqësore dhe dënimet, menagjimi i sallës së seancave, menagjimi i rasteve, si dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve. Këto programe janë ofruar në baza të rregullta si pjesë e trajnimit vjetor në IGJK-së gjatë viteve 2003, 2004, dhe 2005.

Programet fillestare për edukim ligjor

Për t'u bërë gjyqtarë dhe prokurorë, kandidatët duhet t'i nënshtrohen provimit juridik. Kandidatët që kalojnë duhet të përcjellin trajnimet par se të emërohen, në mënyrë që ata të përgatiten për rolin e tyre në gjyqësi. Në këtë kontekst, projekt ligji mbi IGJK-në parasheh që IGJK-ja duhet të jetë përgjegjëse për organizimin e këtyre programeve fillestare. Pas vendimit të tanishëm të Këshillit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, programi i parë edukativ fillestar kishte filluar më 15 prill 2005 si një pilotprojekt tremujor. Për momentin janë duke u trajnuar 60 kandidatë për pozita të gjyqtarëve.

Përveq këtyre programe trajnuese, që nga fillimi i marsit 2005, IGJK-ja ka filluar ofrimin e kurseve themelore për gjyqtarët ndihmës.

PARTNERITETI

IGJK-ja bashkëpunon ngushtë me disa organizata, aktivitetet e të cilave janë të ndërlidhura me trajnimet gjyqësore. Ka një bashkëpunim të ngushtë në mes IGJK-së dhe Agjensionit evropian për rindërtim, Këshillin e Evropës dhe me Departamentin e Drejtësisë të SHBA. Gjithashtu, me qëllim të përbushjes së nevojave të trajnimeve gjyqësore, IGJK-ja bashkëpunon në baza ad hoc me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, siç janë SHPK-ja, ABA- CEELI, Banka Botërore etj

PERSONELI DHE KUALIFIKIMET

IGJK-ja ka selinë në Prishtinë/Priština, dhe personeli i saj përbëhet nga dy ndërkombëtarë të caktuar nga OSBE-ja dhe 18 vendor. Objekti i IGJK-së përfshinë bibliotekën me qasje në internet dhe me pajisje për përkthim simultan që i mundëson IGJK-së të ofrojë përkthime në dhe nga gjuha shqipe, serbe dhe angleze.